



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr. 625/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada-Gillogjani anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesat e Enver Bunjaku, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Podujevë, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), paraqitur kundër vendimit për shpalljen e rezultateve përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 08.11.2017, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 13.11.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**REFUZOHEN** si të pabazuara ankesat e Enver Bunjaku, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Podujevë, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me shenjë ZL.Anr.625/2017 dhe ZL.Anr.626/2017 të datës 09.11.2017, të parashtuara kundër vendimit për shpalljen e rezultateve përfundimtare nga KQZ më datë 08.11.2017, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017

## A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar ankesat ZL.Anr.625/2017 dhe ZL.Anr.626/2017 me datën 09.11.2017 në ora 12:15, nga parashtuesi i ankesave Enver Bunjaku, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Podujevë, nga radha e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega Podujevë. Në ankesat e parashtuara nga ankuesi pretendohet se ka pasur parregullsi në vendvotimet:1814e/01,1814e/03 Sfeqel, 1815/01R,1815/02R Shtedim, 1829e/01R,1829e/02R dhe kërkon nga paneli të bëhet rinumërimi i votave.

Paneli, në bazë të nenit 8.3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka bashkuar ankesat e lartcekura dhe i trajton si një ankesë evidentuar me ZL.Anr.625/2017, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve dhe të dy ankesat i vendosi me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës .

PZAP-i, pas shqyrtimit të besueshmërisë dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

**Ankesat janë të pabazuara**


Paneli pas vlerësimit të pretendimeve ankimore të ankuesit gjeti se ankuesi nuk ka ofruar asnjë provë me të cilën pretendon se ka pasur parregullsi në vendvotimet e cekura më lartë. Prandaj Paneli ankesat e ankuesit i konsideron si të përgjithësuara dhe të pa argumentuara me fakte dhe si të tilla jo bindëse pasi që nuk i plotësojnë kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 117 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithme në Republikën e Kosovës.

Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në ankesa, konstaton se ankesat në fjalë janë të pabazuara dhe pretendimet e tij nuk i ka argumentuar me asnjë provë dhe si të tilla ankesat e ankuesit i refuzoj.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

ZL.Anr.625/2017 më datën 13.11.2017.



#### ***Udhëzim Juridike:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*